REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI I TIRANËS

AKADEMIA E STUDIMEVE ALBANOLOGJIKE

Nr. 3004 Prot.
Tiranë, më 27/6/2019

Nr. 257 Prot.
Tiranë, më 27/06/2019

**MARRËVESHJE**

për

**BASHKËPUNIM NË FUSHËN E ARSIMIT TË LARTË DHE KËRKIMIT SHKENCOR**

ndërmjet

**UNIVERSITETIT TË TIRANËS**

dhe

**AKADEMISË SË STUDIMEVE ALBANOLOGJIKE**

Universiteti i Tiranës, i përfaqësuar nga Rektori Prof. Dr. Mynyr Koni dhe Akademia e Studimeve Albanologjike i përfaqësuar nga Rektori Akademik prof.dr. Marenglen Verli, bien dakord të bashkëpunojnë për nxitjen e shkëmbimeve të shumanshme në funksion të zhvillimit institucional.

## I

Bashkëpunimi ndërmjet të dy institucioneve do të përfshijë:

a) fushat akademike me interes të përbashkët bazuar në parimet e barazisë dhe reciprocitetit;
b) shkëmbimin e stafit akademik, të kërkuesve dhe të studentëve në kuadrin e veprimtarive kërkimore shkencore;
c) nxitjen, mbështetjen dhe realizimin e projekteve të përbashkëta kërkimore;
d) nxitjen, mbështetjen dhe realizimin veprimtarive të tjera shkencore (konferenca, seminare e botime në fusha me interes të dyanshëm);
e) shkëmbimin e literaturës shkencore;
f) hulumtimi i arkivit të ASA nga personeli akademik dhe studentët e UT

## II

Të dy institucionet bien dakord që realizimi i veprimtarive të mësipërme të kryhet në varësi të burimeve dhe të potencialit të disponueshëm nga secili institucion. Për detajimin e bashkëpunimit në fushat e mësipërme (I/a-f) dhe ndjekjen e zbatimit të Marrëveshjes, ngrihet një Komision i Përbashkët i përbërë nga përfaqësuesi ligjor i Institucionit ose i ngarkuari i tij dhe dy përfaqësues të tjerë, nga secili institucion.

## III

Çdo nen i kësaj Marrëveshjeje mund të ndryshohet, të amendohet ose të revokohet në çdo kohë pas një konsultimi dhe mirëkuptimi reciprok ndërmjet të dy institucioneve.

## IV

Kjo Marrëveshje është e vlefshme për një periudhë 4 (katër) vjeçare nga data e nënshkrimit. Ajo rinovohet automatikisht në mënyrë të heshtur për vitet pasardhëse, kur të dy institucionet janë dakord për këtë.
Mosrinovimi i kësaj Marrëveshjeje bëhet nëpërmjet komunikimit zyrtar nga pala e interesuar të paktën 3 muaj përpara përfundimit të saj.

| | |
|---|---|
| Për **Universitetin e Tiranës** | Për **Akademinë e Studimeve Albanologjike** |
| **REKTORI** | **REKTORI** |
| **Prof. Dr. Mynyr Koni** | **Akademik Prof. Dr. Marenglen Verli** |